

## **Privacy policy i sitit web të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l.**

Në këtë faqe shpjegohen mënyrat e administrimit të sitit web të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l., në lidhje me trajtimin e të dhënave personale të subjekteve që e konsultojnë atë. Bëhet fjalë për një rregullore të përpiluar në zbatim të nenit 13 të Dekretit Ligjor n.196 hyrë në fuqi me datë 30 qershor 2003 (në vijim shënuar si Kodi mbi Privacy) për të gjithë ato subjekte që ndërveprojnë me shërbimet e sitit web të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l. në rrugë informatike duke klikuar: <http://www.consorziobrio.it> që është faqja hyrëse e sitit zyrtar të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l. Rregullorja është përpiluar specifikisht për sitin web të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l. dhe nuk ka fuqi ligjore për site web të tjera që mund të konsultohen nga subjekti përmes link.

Rregullorja përpilohet edhe në rrespektim të Rekomandimit n. 2/2001, që Autoritetet Europiane për mbrojtjen e të dhënave personale, të mbledhura në Grupin e krijuar bazuar në nenin 29 të Udhëzimit n. 95/46/CE, kanë shpallur me datë 17 maj 2001, për të përcaktuar disa nga kriteret minimale për mbledhjen e të dhënave personale on-line dhe, veçanërisht, mënyrat, afatet dhe natyrën e informacioneve që subjektet me të drejtë trajtimi duhet t'u komunikojnë subjekteve të cilët konsultojnë faqet web, përtej motiveve të lidhjes.

### **“Subjekti me të drejtë” trajtimi**

Pas konsultimit të këtij siti mund të trajtohen të dhëna në lidhje me subjekte të identifikuar ose të identifikueshëm. “Subjekti me të drejtë” trajtimi të të dhënave të tyre është BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l. me seli ligjore në BARI, Via Maestri del Lavoro, 1.

### **Vendi i trajtimit të të dhënave**

Trajtimet e të dhënave të lidhura me shërbimet web të këtij siti kryhen pranë selisë së sipërpërmendur nën kujdesin e punonjësve të BRIO Group Soc. Coop. Consortile a r.l., të ngarkuar me detyrën e trajtimit të tyre. Çdo e dhënë personale ardhur nga shërbimi web nuk shpërndahet.

Të dhënat personale të lëna nga subjektet konsultues përdoren vetëm për të kryer shërbimin ose aktivitetin e kërkuar dhe u komunikohen palëve të treta vetëm në rast se ky bëhet i nevojshëm pikërisht për këtë arsye.

### **Llojet e të dhënave të trajtuara**

*Të dhënat e lundrimit on-line*

Sistemet informatike dhe procedurat software të përdorura për funksionimin e këtij siti web mbledhin, gjatë përdorimit të zakonshëm të tyre, disa të dhëna personale, transmetimi i të cilave është i nënkuptuar gjatë përdorimit të rrjetit Internet që rezulton i bazuar në protokollin TCP/IP.

Flitet për informacione që nuk mbledhen për t'iu bashkëngjitur subjekteve të interesuara e të identifikuar, por që pikërisht për natyrën e tyre mundet që, përmes përpunimit dhe bashkëngjijtes me të dhëna në mbajtje nga palë të treta, të lejojnë identifikimin e subjekteve konsultues lundruar on-line.

Në këtë kategori të dhënash përfshihen “adresat IP” ose rregullimet e kodifikuara të kompjuterave të përdorur nga subjektet që konsultojnë sitin, adresat me siglën URI (Uniform Resource Identifier) e burimeve të kërkuara, orari i kërkit, mënyra e përdorur për të dërguar kërkesën drejt serverit web, volumi i file që merret në përgjigje, kodin numerik që identifikon gjendjen e përgjigjes së dhënë nga serveri web (rezultat pozitiv, gabim, etj..) si dhe parametra të tjerë që lidhen me sistemin operativ dhe ambientin informatik të subjektit konsultues. Këto të dhëna përdoren vetëm për të mbledhur informacione statistikore të pidentifikuara mbi përdorimin e sitit si dhe për të kontrolluar funksionimin e rregullt të sitit web të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l..

Theksohet se të dhënat e sipërpërmendura mund të përdoren për verifikimin e përgjegjësisë në rast veprash penale informatike në dëm të sitit web të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l. apo të siteve të tjera të lidhura ose të bashkëlidhura me të: me përjashtim të kësaj rrethane, aktualisht të dhënat e kontakteve web nuk ruhen më tej se për pak ditë.

*Të dhëna lënë vullnetarisht nga subjekti konsultues*

Kërkesa për dërgimin e postës elektronike në adresat e specifikuar në seksionin përkatës të sitit web të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l. sjell për pasojë mbledhjen e disa të dhënave personale të kërkuarit, duke përfshirë këtu adresën e-mail të këtij të fundit, e nevojshme kjo për t'ju përgjigjur kërkesave. Rregullore specifike e të përmbledhura

do të sillen ose do të mund të konsultohen më tej në faqet e sitit krijuar enkas për këto shërbime të veçanta nëse ato kërkohen. Cookies Nuk përdoren cookies për transmetimin e informacioneve të karakterit personal, sikurse dhe nuk përdoren të ashtuquajturit cookies të përhershëm të çdo lloji, apo sisteme për gjurmimin e subjekteve konsultues. Përdorimi i të ashtuquajturve cookies të seksionit (që nuk memorizohen përgjithmonë në përpunuesin e subjektit konsultues të sitit dhe që normalisht fshihen me mbylljen e browser) është i kufizuar vetëm për transmetimin e identifikuesve të seksionit të nevojshëm për të mundësuar eksplorimin e sigurt dhe të volitshëm të sitit. Të sipërpërmendurit cookies të seksionit të përdorur në këtë sit të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l. evitojnë që të përdoren teknika të tjera informatike të cilat potencialisht mund të çënojnë fshehtësinë e lundrimit on-line të subjekteve konsultues si dhe nuk mbledhin të dhëna personale identifikuese të subjektit konsultues.

### **Vullnetshmëri për lënie të dhënash personale**

Përtej përsa specifikuar në lidhje me të dhënat e lundrimit on-line, subjekti konsultues është i lirë të lërë të dhënat personale duke plotësuar formularët elektronikë përkatës për kërkesën , në seksionet e sitit web krijuar enkas për shërbime të veçanta nëse ato kërkohen. Theksohet gjithashtu se moslënia e të dhënave personale mund të sjellë për pasojë pamundësinë për të përfituar nga përsa kërkuar.

### **Mënyrat e trajtimit të të dhënave dhe masat e sigurisë.**

Të dhënat personale trajtohen me instrumenta të automatizuar dhe mekanikë, vetëm për periudhën kohore të nevojshme për të arritur qëllimin për të cilin janë mbledhur. Janë ndërmarrë masa sigurie specifike për të parandaluar humbjen e të dhënave, përdorime të jashtëligjshme apo të parregullta si dhe hyrje të paautorizuara. Në veçanti, në seksionet e sitit web krijuar për shërbime të veçanta, ku kërkohen të dhënat personale të subjektit konsultues lundruar on-line, të dhënat kodifikohen përmes një teknologjie për sigurinë të quajtur Secure Sockets Layer, shkurtimisht SSL. Teknologjia SSL kodifikon informacionet përpara sesa ato të shkëmbehen nëpërmjet rrjetit internet mes përpunuesit të subjektit konsultues dhe sistemeve qendrore të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l. duke i bërë ato të pakuptueshme për subjektet e paautorizuar si dhe duke garantuar kështu fshehtësinë e informacioneve të transmetuara.

Sidoqoftë, përdorimi i SSL kërkon një browser të pajtueshëm në gjendje të kryejë “shkëmbimin” e një kodi sigurie me gjatësi minimale prej 128 bit., i nevojshëm ky për të krijuar lidhjen e sigurt të sipërpërmendur me sistemet qendrore të BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l.

### **Të drejtat e të interesuarve**

Subjektet të cilëve u referohen të dhënat personale, të mbledhura kryesisht në seksionet specifike të sipërpërmendura, në çdo moment kanë të drejtë të marrin konfirmimin për ekzistencën ose jo të këtyre të dhënave si dhe të njihen me përmbajtjen e origjinën, të verifikojnë saktësinë ose të kërkojnë plotësimin, ose freskimin, apo edhe ndryshimin sipas nenit 7 të Kodit mbi Privacy. I interesuari ka të drejtë të kërkojë fshirjen, shndërrimin në gjendje anonime, si dhe të apelojë në çdo rast, për arsye të justifikueshme, trajtimin e tyre. Kërkesat e mundshme duhen nisur në adresën elektronike: [info@consorziobrio.it](mailto:info@consorziobrio.it) ose dërguar me postë në adresën BRIO group Soc. Coop. Consortile a r.l., Via Maestri del Lavoro, 1, 70123 Bari (BA).

### **Të miturit**

BRIO Group Soc. Coop. Consortile a r.l. nuk e përdor në mënyrë të vetëdijshme sitin web të saj për t'u kërkuar të dhëna subjekteve të mitur nën 18 vjeç.